




DPK/DMP
02

03-3873/13
14.11.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN/ OSNOVNI SUD U PRIZRENU/ BASIC COURT IN PRIZREN

Nr.465-05/2012

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Divizioni për Kundërvajtje, me gjyqtarin **Gjimshit Galushi**, dhe procesmbajtësen **Nexhla Vebiqi** në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **Ridvan Hoxha nga Prizreni**, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5. dhe 6. par.1.3 .si dhe nenit 9 , të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarim, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e në bazë të nenit 195 të LMK-së , me datën 03.10.2013 merr këtë :

A K T V E N D I M

I pandehuri Ridvan Misin Hoxha, i lindur me 1954 në fsh. Zhur KK Prizren, me vendbanim në Prizren në rrugën Hoxhë Tasini nr.114

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, sipas kërkesës së Agjencionit , e si Zyrtare i lartë publik – deputetë në asamble komunale në Prizren , nuk e ka bërë deklarin e pasurisë dhe prejardhjen e saj , pranë Agjensisë kundër Korrupsionit - brenda afatit Ligjor (deri më 31.03.2012) , edhe pse ka qenë i obliguar ,

- me kete veprim ka kryer kundervajtjen nga neni 5. dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit 17.par.1.3 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik , e për këtë , duke aplikuar nenin 9 të LMK-së .

D E N O H E T

Me gjobë në lartësi prej 350 (treqind e pesëdhjetë)Euro .

I pandehuri obligohet që denimin e shqiptuar me gjobë , ta paguajë në afat prej 15 ditëve , nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktvendimi . Poqese këtë nuk e bën në afatin e caktuar , atëherë gjoba e shqiptuar do të zavendsohet me burgim , duke llogaritur 20 euro për një ditë burgu , kurse në afatin e njejtë në emër të shpenzimeve gjyqësore, do të paguajë shumë prej 5 (pesë) euro, nën kërcnim të ekzekutimit të dhunshëm .

Sipas kërkesës së Agjencisë kundër Korupsionit të Republikës së Kosovës - në Prishtinë , me nr.01-1880-2012 të datës **24.05.2012** , u zhvillua procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit lartëcekur , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5, dhe 6.par.1.3 të ndëshkuar sipas nenit **17.par.1.3** të **Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik** .

Gjendja faktike është vërtetuar në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës , si dhe deklaratës të pandehurit , i cili në deklaratën e tij ka theksuar se është e vërtet që deklarin e pasurisë e ka bërë pak me vonesë ,pasi që një kohë të gjatë e ka bojkotuar të gjitha seancat e Kuvendit Komunal, me shenjë proteste për parregullsitë të cilat kanë egzistue, e poashtu që edhe njoftimin-formularin për deklarin e pasurisë ka marur me vonesë, të cilën pastaj e ka plotësuar , dhe me datën 15.12.2012 e ka dërguar Agjencionit kundër korupsionit të Republikës së Kosovës, i cili edhe është pranuar me të njejtën date.


Nga të dhënat e parashtruar në kërkesë , vlerësimi të deklaratës së të pandehurit , si dhe vlerësimi të të gjitha provave së bashku dhe secilës veç e veç të bashkangjitura në kërkesë , Gjykata konstatoi se me datën **15.12.2012** i pandehuri me të vërtet kishte plotsuar , por edhe ka dërguar formularin mbi deklarin e pasurisë Agjencionit kundër korupsionit , i cili ishte pranuar me të njejtën datë , edhe pse pas afatit për dorzim .

Duke pasur parasysh rethanat nga neni **7 të LMK-së** , se i njejt ka patur sjelljet korekte , e poashtu faktin se me vonesë është njoftuar me formularin mbi deklarin e pasurisë, se nga afati ligjorë për deklarin e pasurisë kanë kaluar disa muaj , mirpo egziston fakti se i pandehuri në fjal edhe pse me vonesë , e ka përmbush obligimin e vet, gjykata është qëndrimt se në veprimet e të pandehurit egzistojnë elementet e veprës së kundërvajtjes nga dispozitat e shenuara më lartë , e duke aplikuar nenin **9 të LMK-së** , e ka zbutur denimin , duke patur parasysh sjelljen e tij korekte , se deklarin me vonesë ka bër nga mos prezenca-bojkoti i tijë , **në seancat komunale, njoftimi vonshëm nga ana e organit kompetent për deklarin e pasurisë**, me bindje se edhe me këtë llojë të denimit do të arihet qëllimi i ndëshkimit , që i njejt në të ardhmen të mos kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme , dhe të respektoj afatin ligjore .

Vendimi mbi shpenzimet gjyqsore është marrë konform nenit **109.2 të LMK-së** .

Me sa u cek me larte, u vendos si ne dispozitiv te aktvendimit .

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Divizioni për Kundërvajtje
Nr.465-05/2012, datë: 03.10.2013



Gjyqtari
Gjimshir Galushi

UDHËZIMI JURIDIK : Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur , mund të ushtrojë ankesë , Gjykatës së Apelit - Divizionit për Kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej **8** ditëve , pas marrjes të të njejtit , përmes kësaj Gjykate .